



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 490 Prot.

Tiranë më 10.2.2025

VENDIM

Nr. 03, datë 07.02.2025

“Për miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të Universitetit të Tiranës”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 1, germa “d”, neni 60 dhe neni 61; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 37 dhe neni 38, si dhe VKM nr. 112, datë 23.02.2018, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, të ndryshuar, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e datës 07.02.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të Universitetit të Tiranës”.
2. Vendimi i përcillet KPPA-së dhe të gjitha njësive përbërëse të Universitetit të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Prof. Dr. Artan Hoxha

RREGULLORE
"PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT PËR PROMOVIMIN E
PERSONELIT AKADEMIK (KPPA) DHE PROCESIT PËR FITIMIN E TITUJVE
AKADEMIKË NË UNIVERSITETIN E TIRANËS"

Miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr, 3, datë 07.02.2025, Tiranë

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të sigurojë që promovimi i personelit akademik të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë dhe parimeve etike në kërkimin shkencor, të cilat garantojnë për: cilësinë e kërkimit, pasqyruar në konceptin, metodologjinë, analizën dhe përdorimin e burimeve; ndershmërisë në zhvillimin, ndërmarrjen, shqyrtimin dhe komunikimin e kërkimit në një mënyrë transparente, të drejtë dhe të paanshme; respektin për kolegët, pjesëmarrësit në kërkim, shoqërinë, ekosistemet, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin; si dhe përgjegjshmërinë për kërkimin që nga ideja deri në botim, për menaxhimin dhe organizimin e tij, mbikëqyrjen dhe udhëheqjen dhe çdo ndikim tjetër më të gjerë.

Neni 2
Objekti

Kjo rregullore përshkruan kuadrin e brendshëm rregullator të veprimtarisë së Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik të Universitetit të Tiranës (më poshtë KPPA ose Komisioni), detyrimet e strukturave të tjera përgjegjëse, të njëjve kryesore dhe njëjve bazë, për promovimin e personelit akademik, si dhe të drejtat dhe detyrimet e kandidatëve që aplikojnë për fitimin e titujve akademikë.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*; Ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 *"Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"*; VKM, nr. 112, datë 23.02.2018, *"Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor"*, i ndryshuar me VKM Nr. 808 datë 11.12.2019 dhe VKM Nr.128 datë 06.03.2024; Statutit të Universitetit të Tiranës; Rregullores të Universitetit të Tiranës dhe Kodit të Etikës të Universitetit të Tiranës, Vendimit nr. 4 datë 29.01.2020 të Senatit Akademik.



Neni 4

Fusha e veprimit

Kjo rregullore, zbatohet nga Komisioni dhe strukturat e tjera përgjegjëse, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"* si dhe VKM nr. 112, datë 23.02.2018 *"Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor"*, i ndryshuar; Statutit të Universitetit të Tiranës, Rregullores të Universitetit të Tiranës dhe Kodit të Etikës të Universitetit të Tiranës.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONET E KOMISIONIT PËR PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK

Neni 5

Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA)

Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik është organ kolegjal i Universitetit të Tiranës, i krijuar në nivel institucioni për promovimin e personelit akademik.

Neni 6

Përbërja e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik

1. KPPA përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të cilët mbajnë titullin "Profesor".
2. Anëtarët e KPPA vetëkandidojnë dhe përzgjidhen nga Senati Akademik.
3. Në përbërje të KPPA-së do të ketë të paktën një anëtar nga çdo fakultet i Universitetit të Tiranës.
4. Anëtari i KPPA-së do të plotësojë këto kriterë:
 - a. të jetë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës;
 - b. të mbajë titullin akademik "Profesor" dhe të ketë së paku 5 (pesë) vite përvojë në mësimdhënie, pas, fitimit të këtij titulli;
 - c. të ketë përvojë pune si anëtar i personelit akademik të paktën 10 (dhjetë) vjet;
 - d. të mos jetë anëtar i zgjedhur në organet drejtuese të njësisë bazë, të njësisë kryesore apo të Universitetit të Tiranës;
 - e. të mos bëjë pjesë në asnjë komision tjetër të përhershëm të Universitetit të Tiranës.
5. Kryetari i KPPA-se, përzgjidhet nga Senati Akademik i UT-së.
6. Komisioni ka një zëvendëskryetar, i cili caktohet nga rradhët e anëtarëve të Komisionit, me funksion zëvendësimit të kryetarit, në rast mungese të tij ose, në rast delegimi të drejtimit të Komisionit.
7. KPPA ka një sekretar teknik, i cili nuk është anëtar i tij.



Neni 7

Mandati i anëtarit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik

1. Mandati i anëtarit të Komisionit është 2 (dy) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
2. Mandati i anëtarit të Komisionit, fillon në datën kur Senati Akademik, e miraton si anëtar të Komisionit.
3. Mandati i anëtarit të Komisionit përfundon:
 - a. me mbarimin e afatit;
 - b. me dorëheqjen;
 - c. kur ndërpret marrëdhëniet e punës me Universitetin e Tiranës;
 - d. kur mungon pa arsye në mbledhjet e Komisionit për 4 (katër) seanca radhazi;
 - e. kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkak të kryerjes së një vepre penale;
 - f. në rastet e pamundësisë për të kryer detyrën;
 - g. në rastet e shkeljeve të rënda të ligjit, të cilat provohen me vendim të gjykatës kompetente apo të një autoriteti administrativ të varësisë;
 - h. kur mbush moshën e pensionit.
4. Vendi bosh i anëtarit të Komisionit plotësohet me kandidatin e radhës nga njësia kryesore që mbetet pa përfaqësim, të përzgjedhur nga Senati Akademik. Kur në listën e votuar nga Senati Akademik, nuk ka përfaqësues nga njësia kryesore që mbetet pa përfaqësim, për të plotësuar vendin bosh, do të kryhet një proces i ri përzgjedhjeje.

Neni 8

Funksionet e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik

KPPA kryen funksionet si më poshtë:

- a. vepron në zbatim të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë;
- b. bashkëpunon me njësitë kryesore dhe njësitë bazë, për realizimin e procedurave të aplikimit dhe vlerësimit;
- c. miraton paketën me formularë, skeda dhe formate dokumentesh për procedurat e aplikimit dhe të vlerësimit;
- d. shqyrton dhe vlerëson përmbushjen nga kandidatët të standardeve shtetërore për titujt akademikë, të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- e. emëron jurinë që vlerëson përmbushjen e standardeve shtetërore të titujve akademikë, cakton kryetarin e saj dhe mbikëqyr funksionimin e jurisë;
- f. merr vendimin përfundimtar për dhënien e titujve akademikë;
- g. ndjek procedurën për regjistrimin e titujve akademikë në regjistrin shtetëror të gradave dhe titujve akademikë, si edhe në regjistrat e brendshëm institucionalë të regjistrimit të titujve akademikë.



- h. shqyrton dhe merr vendim për ankesat e kandidatëve lidhur me procedurat dhe vlerësimet e kryera për ata.
- i. zëvendëson anëtarin e Jurisë së dorëhequr me njërin prej anëtarëve të tjerë nga 8 (tetë) propozimet e paraqitura nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe të miratuara nga Rektori i Universitetit të Tiranës.
- j. është përgjegjës dhe ndjek çdo procedurë tjetër, të përshkruar në Ligjin për arsimin e lartë, dhe aktet ligjore të miratuara në zbatim të tij, Statutin e UT-së dhe këtë rregullore, në lidhje me procesin e promovimit të personelit akademik për fitimin e titujve "Profesor" dhe "Profesor i Asociuar".

Neni 9

Mbledhjet e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik

1. Si rregull, mbledhjet e Komisionit thirren nga Kryetari i KPPA-së.
2. Thirrja e mbledhjes mund të bëhet edhe me kërkesë nga të paktën 3 anëtarë të Komisionit, të cilët duhet të përcaktojnë çështjet, për të cilat kërkohet të thirret mbledhja. Kërkesa në këtë rast i dërgohet Kryetarit të KPPA-së, i cili, pasi e shqyrton atë në lidhje me pajtueshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator të zbatueshëm, njofton thirrjen e mbledhjes brenda 7 (shtatë) ditësh pas marrjes së një kërkesë të tillë.
3. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes, së bashku me rendin e ditës bëhen nëpërmjet postës elektronike, ose publikohet në platformën elektronike të punës së përbashkët të KPPA-së, të paktën 4 (katër) ditë kalendarike përpara ditës së mbledhjes.
4. Kërkesat për të futur në rendin e ditës çështje të tjera, duhet të bëhet nëpërmjet postës elektronike, të paktën 4 (katër) ditë kalendarike para datës së vendosur për mbledhjen.
5. Çdo ndryshim në rendin e ditës, në datën dhe orën e përcaktuar për mbledhjen, ju njoftohet të gjithë anëtarëve të Komisionit nga sekretari teknik, të paktën 2 (dy) ditë kalendarike përpara datës së mbledhjes.
6. Në momentin e lajmërimit të mbledhjes për anëtarët e KPPA-së, sekretari teknik dërgon në formë elektronike (me e-mail), të gjithë materialet, në përputhje me kërkesat në skedën e miratuar (dosjet, raportet, vërtetimet, shkresat përcjellëse dhe relacionet përkatëse, si edhe çdo dokument tjetër që lidhet me dosjen e kandidatit), për të cilat KPPA do të diskutojë në mbledhje.
7. Mbledhja e Komisionit është e vlefshme nëse në të janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të KPPA-së.
8. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, kryetari vendos për thirrjen përsëri të mbledhjes në një ditë tjetër, e cila do të jetë të paktën 24 orë pas mbledhjes së parë.



Neni 10

Marrja e vendimeve

1. Komisioni merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, me përjashtim të rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve të pranishëm në mbledhje, vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për çështje që nuk janë në rendin e ditës.
2. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
3. Si rregull, votimi është i hapur. Komisioni rast pas rasti, mund të vendosë për çështje për të cilat vlerëson se, për marrjen e vendimeve, votimi duhet të jetë i fshehtë.
4. Anëtarët e Komisionit, që janë të pranishëm në mbledhje dhe nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar, shprehin qëndrimin e tyre "pro"/ "kundër". Mendimi "kundër paraqitet me shkrim dhe i bashkëngjitet vendimit të Komisionit. Anëtarët e KPPA-së, të cilët për arsye objektive, nuk janë të pranishëm në mbledhje, kanë të drejtë të paraqesin votën e tyre me shkrim.
5. Kryetari i Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik voton i fundit.
6. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit llogaritet si dy vota.
7. Vendimet nënshkruhen nga Kryetari i Komisionit. Një kopje e vendimit duhet nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KPPA-së, që do të mbetet në dokumentacionin e Komisionit.

Neni 11

Procesverbali

1. Në çdo mbledhje të KPPA-së mbahet procesverbal për zhvillimin e mbledhjes. Procesverbali përmban informacion për pjesëmarrësit, për agjendën e mbledhjes, miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mëparshme, diskutimet, rezultatin e votimit dhe vendimet e marra.
2. Procesverbali mbahet nga sekretari teknik i Komisionit, i cili ua përcjell anëtarëve të KPPA-së së bashku me dokumentet e tjerë të mbledhjes pasardhëse.
3. Miratimi i procesverbalit është pika e parë e rendit të ditës të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari.
4. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë të regjistrojë në procesverbal mos aprovimin/mendimin "kundër" mbi argumente të veçantë, si edhe të kërkojë përfshirjen e çdo deklarimi që ai ka bërë gjatë mbledhjes ose të parapërgatitur, në lidhje me çështjet sipas rendit të ditës, kur nuk e ka patur të mundur pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në mbledhje.



Neni 12

Formalizimi i vendimeve

1. Vendimet e Komisionit zbardhen nga sekretari teknik, jo më vonë se pesë ditë pune nga përfundimi i mbledhjes.
2. Për efekt të ndjekjes së procedurave administrative, vendimet për miratimin e titujve hartohen në katër kopje: një kopje ruhet në dokumentacionin e Komisionit, një kopje ruhet në njësinë kryesore pranë së cilës kandidati ka depozituar kërkesën për promovim, një kopje ruhet në Sektorin e Protokoll Arkivës së UT-së dhe një kopje i jepet kandidatit.
3. Vendimet e Komisionit publikohen në faqen zyrtare të UT-së.

Neni 13

Të drejtat dhe detyrimet e anëtarit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik

1. Anëtari i KPPA-së ka këto të drejta:

- a. të marrë informacionin e nevojshëm dhe të duhur për çështjet që lidhen me veprimtarinë e KPPA-së;
- b. të propozojë mbajtjen e mbledhjes dhe përfshirjen e çështjeve të ndryshme në rendin e ditës;
- c. të jetë relator i Komisionit;
- d. të shprehë mendimin "kundër" për vendimet e komisionit kur gjykon dhe vlerëson ndryshe.

2. Anëtari i KPPA ka këto detyrime:

- a. të marrë pjesë rregullisht, fizikisht ose virtualisht (kur mbledhja zhvillohet në distance), në të gjithë mbledhjet e komisionit, me përjashtim të rasteve kur ka arsye objektive të pamundësisë së pjesëmarrjes, për të cilat njofton paraprakisht me shkrim kryetarin e KPPA-së;
- b. të jetë pjesëmarrës aktiv për çështjet që janë objekt i veprimtarisë së Komisionit;
- c. të respektojë legjislacionin në fuqi, standardet shtetërore dhe institucionale për dhënien e titujve akademikë dhe standardet etike;
- d. të angazhohet si relator i Komisionit për vlerësimin e aplikimeve të kandidatëve dhe të dokumentacionit të përcjellë nga njësia kryesore, përfshirë relacionet e jurisë;
- e. të respektojë afatet kohore për realizimin e detyrave dhe procedurave sipas parashikimeve ligjore dhe administrative;
- f. të vetëdeklarojë dhe shprehet për rastin e konfliktit të interesit;
- g. të ruajë konfidencialitetin e diskutimeve dhe debateve të zhvilluar në mbledhjet e Komisionit.



Neni 14

Detyrat e Kryetarit të Komisionit

1. Kryetari i Komisionit kryen këto detyra:

- a. drejton dhe organizon veprimtarinë e Komisionit;
- b. thërret dhe drejton mbledhjet e KPPA-së, cakton rendin e ditës, drejton diskutimet dhe koordinon punën;
- c. shqyrton kërkesat për thirrjet jashtë radhe të mbledhjeve të KPPA-së, të paraqitura nga të paktën 3 anëtarë si dhe kërkesat për ndryshime në rendin e ditës të mbledhjes, sipas afateve të përcaktuara në këtë rregullore;
- d. organizon punën për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave në lidhje me procesin e dhënies së titujve akademikë;
- e. informon në mënyrë periodike Rektorin, për ecurinë e vlerësimit të aplikimeve dhe problematikat me të cilat ndeshet KPPA-ja;
- f. i paraqet Senatit Akademik raportin vjetor të veprimtarisë së Komisionit.

2. Kryetari cakton zëvendëskryetarin e Komisionit nga rradhët e anëtarëve të Komisionit.

3. Kryetari ngre grupe pune nga rradhët e Komisionit për shqyrtimin e problematikave të veçanta, që lindin gjatë veprimtarisë së Komisionit.

4. Kryetari i përcjell vendimet e Komisionit, Rektorit të Universitetit të Tiranës.

Neni 15

Detyrat e sekretarit teknik të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik

1. Komisioni asistohet nga një sekretar teknik, i cili është punonjës me kohë të plotë në Rektoratin e UT-së. Sekretari teknik caktohet nga Rektori i Universitetit të Tiranës.

2. Sekretari teknik ka këto detyra:

- a. administron kërkesat dhe dokumentacionin e dosjeve të aplikantëve për titujt akademikë dhe i raporton kryetarit të Komisionit;
- b. përgatit kushtet teknike dhe administrative për mbarëvajtjen e veprimtarisë të Komisionit;
- c. dërgon anëtarëve të KPPA-së, në mënyrë elektronike, njoftimin me rendin e ditës të mbledhjes, të aprovuar nga kryetari, së bashku me materialet përkatëse të dosjeve të aplikantëve për titujt "Profesor" dhe/ose "Profesor i Asociuar";
- d. merr pjesë në të gjitha mbledhjet e Komisionit dhe mban procesverbalin e mbledhjes;
- e. zbardh vendimet e Komisionit;
- f. administron dokumentacionin e Komisionit;
- g. përgatit dokumentacionin e nevojshëm dhe kushtet teknike për mbledhjen e grupeve të punës që ngrihen nga KPPA-ja për probleme të veçanta;



- h. organizon punën për arkivimin e dosjeve të ardhura dhe atyre të përfunduara si dhe dokumentacionin e KPPA-së;
- i. regjistron të dhënat në Regjistrat Institucionalë për titullin akademik "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor";
- j. kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkon Komisioni dhe kryetari i tij, brenda fushës së veprimtarisë.

3. Në rast mungese, për arsye objektive, për një mbledhje të njoftuar, sekretari zëvendësohet nga anëtar i KPPA- së më i ri në moshë.

KREU III KRITERET DHE PROCEDURAT PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË "PROFESOR I ASOCIUAR" DHE "PROFESOR"

Neni 16 Vlerësimi për plotësimin e kriterëve për fitimin e titujve akademikë

Vlerësimi për fitimin e titujve akademik "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", në zbatim të akteve ligjore, nënligjore, dhe kësaj rregullore, bëhet në përputhje me standardeve shtetërore dhe institucionale për:

- a. veprimtarinë mësimore;
- b. veprimtarinë kërkimore dhe botuese;
- c. pjesëmarrjen në komitete shkencore dhe botuese, në projekte kërkimore-shkencore, në vlerësimin e veprimtarive shkencore, botuese, të projekteve kërkimore dhe për kontributin në transferimin e teknologjisë së patentave.

I. Aplikimi për titullin "Profesor i Asociuar"

Të drejtën për të aplikuar për fitimin e titullit akademik "Profesor i Asociuar" e ka personeli akademik i kategorisë "Lektor", pas të paktën 5 (pesë) vjet, nga data që ka mbrojtur gradën shkencore "Doktor".

1. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin "Profesor i Asociuar", duhet:

- a. të ketë zhvilluar një cikël të plotë leksionesh për, së paku, një lëndë, për 3 (tri) vite akademike;
- b. të ketë përvojë pune si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë, së paku, 5 (pesë) vjeçare, me apo pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme si lektor, për një periudhë 8 (tetë) vjeçare akademike, me apo pa ndërprerje. Personeli akademik që ka përvojë akademike me kohë të plotë më të ulët se 5 (pesë) vite, por ka përvojë pune si personel akademik me kohë të pjesshme më të ulët se 8 (tetë) vite, koha e pjesshme i konvertohet si vite me kohë të plotë: 1.6 (një pikë gjashtë) vite përvojë pune me kohë të pjesshme



konvertohet me 1 (një) vit përvojë pune me kohë të plotë, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor;

- c. të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle ose të mbrojë në një nga gjuhët e mësipërme, veprimtarinë kërkimore botuese, përpara jurisë, të ngritur me vendim të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloren e UT-së.

2. Personeli akademik, që aplikon për titullin "Profesor i Asociuar", duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:

- a. Ka botuar së paku, 5 (pesë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 2 (dy) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI). Kur këta artikuj janë në bashkëautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i vetëm ose i parë në të paktën dy artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit.
- b. Ka realizuar si autor i parë, së paku 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku, 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(II) Aplikimi për titullin "Profesor"

Të drejtën për të aplikuar për fitimin e titullit akademik "Profesor" e ka personeli akademik, i cili ka titullin akademik "Profesor i Asociuar", për të paktën, 5 (pesë) vite nga data e fitimit të këtij titulli.

1. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin akademik "Profesor", duhet:

- a. të ketë qenë titullar lënde ose moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë shkencore për një periudhë jo më të shkurtër se 5 (pesë) vite akademike;
- b. të jetë ose të ketë qenë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë 8 (tetë) vjeçare akademike, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor", ose me kohë të pjesshme, për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) vjeçare akademike pas fitimit të gradës shkencore "Doktor". Personeli akademik që ka përvojë akademike me kohë të plotë më të ulët se 8 (tetë) vite, por ka përvojë pune si personel akademik me kohë të pjesshme më të ulët se 12 (dymbëdhjetë) vite, koha e pjesshme i konvertohet si vite me kohë të plotë: 1.5 (një pikë pesë) vite kohë e pjesshme konvertohet me 1 (një) vit përvojë pune me kohë të plotë, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor";



- c. të ketë udhëhequr ose bashkëudhëhequr, të paktën 2 (dy) doktorata. Bashkëudhëheqja duhet të jetë me personel akademik të kategorisë "Profesor", me Institucione të Arsimit të Lartë (IAL) brenda ose jashtë vendit, në bazë të një marrëveshjeje dypalëshe. Në rast se kandidati ushtron veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, duhet të ketë udhëhequr / bashkëudhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë të përfunduar, ndërsa kriteri për udhëheqjen e doktoratës tjetër konsiderohet i plotësuar nëse kandidati është angazhuar në mësimdhënie në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të paktën për një periudhë prej 6 (gjashtë) muajsh pa ndërprerje ose 1 (një) vit me ndërprerje, në tri vitet e fundit.

Për personelin akademik me kohë të plotë ose të pjesshme, që aplikon deri në fillimin e vitit akademik 2026-2027, për titullin akademik "Profesor", kriteri i mësipërm i udhëheqjes apo bashkëudhëheqjes se të paktën dy doktoratave, konsiderohet i plotësuar nëse aplikanti ka udhëhequr/bashkëudhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë të përfunduar. Në rast se kandidati ushtron veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel-akademik me kohë të plotë, kriteri i udhëheqjes/bashkëudhëheqjes së një doktorate do të konsiderohet i plotësuar nëse kandidati është duke udhëhequr/bashkëudhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë, në qoftë se përmbush edhe një nga kushtet e mëposhtme:

- i. të ketë pasur ose ka rolin e drejtuesit në një projekt ndërkombëtar;
 - ii. të ketë dhënë ose jep mësim në një program në gjuhë të huaj në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, spanjolle ose italiane;
 - iii. të ketë përfunduar me sukses së paku të gjitha detyrimet e vitit të dytë, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të programit të studimit, të doktoratës, të kandidatit doktorant që ka në udhëheqje/bashkëudhëheqje të doktoratës;
- d. të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle ose të mbrojë veprimtarinë kërkimore-shkencore përpara jurisë, të ngritur me vendim të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik në një nga këto gjuhë, në përputhje me statutin dhe rregulloren e UT-së.

2. Personeli akademik, i cili aplikon për titullin "Profesor", duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizmin e detyrimeve, si më poshtë vijon:

- a. Ka botuar së paku, 7 (shtatë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 3 (tre) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI)". Kur këta artikuj janë në bashkëautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i vetëm ose i parë në të paktën katër artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit.
- b. Ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një



nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

Neni 17

Vlefshmëria e botimeve shkencore dhe aftësisë për të mbajtur leksione në gjuhë të huaj për fitimin e titullit akademik "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor"

1. Për fitimin e titullit akademik "Profesor i Asociuar", botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së gradës shkencore "Doktor", deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për fitimin e titullit akademik "Profesor i Asociuar", pranë drejtuesit të Njesisë Kryesore.
2. Për fitimin e titullit akademik "Profesor", botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së titullit akademik "Profesor i Asociuar", deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për fitimin e titullit akademik "Profesor", pranë drejtuesit të Njesisë Kryesore.
3. Njihen si revista shkencore brenda vendit, revistat, të cilat janë përfshirë në listën revistave shkencore të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).
4. Njihen si revista të rankuara në Web of Science dhe Scopus, revistat e përfshira në listat e tyre zyrtare të publikuara online.
5. Njihet si "Proceedings", përmbledhja me botimin e plotë të referimeve të mbajtura në konferencë/kongres/simpozium dhe e pajisur me ISBN ose ISSN.
6. Njihet si monografi, një studim i gjerë e i hollësishëm shkencor, që trajton një çështje a një temë të veçantë.
7. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%, konfirmuar me vërtetimin e plagjiarizmit.
8. Në të gjithë rastet kur kandidati paraqet në dosje artikull shkencor të botuar në revistë ndërkombëtare me faktor impakti të rankuara nga Journal Citation Reports dhe/ose Scopus, këto botime do të ekuivalentohen me botime të rankuara në Web of Science.
9. Njihen botimet në variantin elektronik, që plotësojnë të gjithë treguesit e kërkuar si për variantin e printuar të botimeve.
10. Kandidati që kërkon të promovohet duhet të jetë i aftë të prezantojë përpara jurisë së ngritur me vendim të KPPA-së, në një nga pesë gjuhët e parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi (angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle):
 - a. një leksion, jo më pak se 20 minuta në fushën përkatëse të kërkimit shkencor ose mësimdhënies; ose



- b. një referim, jo më pak se 20 minuta të veprimtarisë kërkimore, në një nga gjuhët e cituar në këtë pikë.

Neni 18

Treguesit për ekuivalentimin e pjesëmarrjes në komitete shkencore dhe botuese, në projekte kërkimorë-shkencorë, në vlerësimin e veprimtarive shkencore, botuese, të projekteve kërkimorë dhe kontributit në transferimin e teknologjisë

1. Për efekt të promovimit akademik, merret në konsideratë angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit, pas fitimit të titullit akademik "Profesor i Asocluar" (*pas fitimit të gradës shkencore "Doktor"*) ose "Profesor" (*pas fitimit të titullit akademik "Profesor i Asociuar"*), në:

- a. komitete shkencore apo redaktuese;
- b. veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues, për llogari të periodikëve ose jo periodikëve shkencorë;
- c. projekte kërkimorë-shkencorë në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtar;
- d. përfitim të financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
- e. projekte të financuar nga programe me donatorë të huaj, të cilët sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
- f. vlerësim projektësh kërkimorë kombëtarë ose ndërkombëtarë si vlerësues;
- g. drejtimin e komiteteve organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare si drejtues i komitetit;
- h. projektet e transferimit teknologjik të patentave.

2. Personel akademik, i cili kërkon të promovohet për titullin akademik "*Profesor i Asociuar*" ose "*Profesor*", kur ka angazhime dhe pjesëmarrje në së paku 4(katër) veprimtari sipas pikës 1, të këtij neni, ka të drejtë të kërkojë ekuivalentimin e tyre me:

- a. 1 (një) artikull shkencor, i botuar në revistë shkencore ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI), ose
- b. 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje dhe 2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

3. Lloji i ekuivalentimit, që kandidati kërkon të përfitojë, duhet të përcaktohet qartë dhe në mënyrë të detajuar nga aplikanti, në kërkesën që i dorëzon drejtuesit të njësive kryesore së bashku me dosjen, në momentin e aplikimit.

4. Niveli sasior i treguesve të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, si dhe vlera përkatëse e tyre sipas pikës 2 të këtij neni, përcaktohet duke u bazuar në Manualin mbi ekuivalentimin e veprimtarive akademiko-didaktike të kandidatëve në kërkim të fitimit të titullit akademik, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.



5. Njësitë bazë dhe Juria në kryerjen e vlerësimit të veprimtarive, duhet të mbajnë parasysh manualin dhe në çdo rast të shprehen qartë në vendimmarrje, duke përshkruar, argumentuar dhe mbështetur me dokumentacion, llojin e ekuivalentimit të miratuar bazuar në kategoritë e angazhimeve që ka kandidati, të cilat kualifikohen për ekuivalentimin përkatës.

Neni 19

Ekuivalentim i monografisë

1. Ekuivalentim i monografisë për titullin "Profesor i Asociuar"

- a. Kur kandidati për titullin "Profesor i Asociuar" paraqet monografi, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuar në shkronjën "a", të nënpikës 2, të pikës I, të nenit 16, të këtij Kreu, në lidhje me, (a) botimin e artikujve shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara sipas ekuivalentimit në vijim.
- b. Me qëllim që monografia shkencore të njihet për qëllime të ekuivalentimit si më sipër, botimi i saj, brenda ose jashtë vendit, duhet të jetë pas fitimit të gradës shkencore "Doktor", të përmbushë kushtet e origjinalitetit, të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit.
- c. Monografia shkencore e botuar brenda vendit konsiderohet e vlefshme për ekuivalentim, nëse është vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) "profesorë" të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre është nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20-ës.
- d. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D.
- e. Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:
 - i. 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit; ose
 - ii. 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me Indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me Indikatorë citimi të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI).
- f. Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:
 - i. 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore brenda vendit; ose
 - ii. 2 (dy) artikuj shkencorë që janë botuar në revista ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI).

2. Ekuivalentim i monografisë për titullin "Profesor"

- a. Kur kandidati për titullin "Profesor" paraqet monografi, ai përjashtohet nga detyrim i përcaktuar në shkronjën "a", të nënpikës 2, të pikës II, të nenit 16, të këtij Kreu, në lidhje me, botimin e artikujve shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara sipas ekuivalentimit në vijim.



- b. Me qëllim që monografia shkencore të njihet për qëllime të ekuivalentimit si më sipër, botimi i saj, brenda ose jashtë vendit, duhet të jetë, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor" dhe pas marrjes së titullit "Profesor i Asociuar", të përmbushë kushtet e origjinalitetit, të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njëسيا bazë, që mbulon fushën e kërkimit.
- c. Monografia shkencore e botuar brenda vendit konsiderohet e vlefshme për ekuivalentim, nëse është vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën 2 (dy) "profesorë" të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet e BE-së, OECD-së ose G20-ës.
- d. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D.
- e. Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:
 - i. 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii. 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revista ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI).
- f. Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:
 - i. 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii. 2 (dy) artikuj shkencorë që janë botuar në revista ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI).

Neni 20

Ekuivalentimi në rastin e studimit posdoktoratë

Në rastet kur kandidati ka realizuar studim postdoktoratë në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, me një kohëzgjatje, të paktën, 6 (gjashtë) muaj, shoqëruar me raport të detajuar për aktivitetin kërkimor-shkencor të zhvilluar gjatë kësaj periudhe, ai ekuivalentohet me:

- a. 1 (një) artikull shkencor të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare të indeksuara në Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI) dhe me
- b. 1 (një) referim të mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtarë të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.



KREU IV

PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE VENDIMMARRJES NË KPPA

Neni 21

E drejta për promovim

Kanë të drejtë të kërkojnë promovim për fitim të titullit akademik pranë Universitetit të Tiranës:

- a. anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë ose kohë të pjesshme, të Universitetit të Tiranës;
- b. anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë të institucioneve të tjerë të arsimit të lartë, të cilët nuk përmbushin kriteret për promovim akademik;
- c. persona, të cilët nuk janë personel akademik pranë ndonjë institucioni, por përmbushin standardet për fitimin e titujve akademikë.

Neni 22

Procedura e aplikimit

Kandidati që kërkon të promovohet, paraqet kërkesën me shkrim dhe dosjen pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili brenda 20 (njëzet) ditëve nga paraqitja e kërkesës ja përcjell për vlerësim njësisë bazë.

Dosja e aplikimit duhet të përmbajë këto dokumente:

- a. Formularin e kërkesës sipas formatit të miratuar nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik;
- b. CV e aktualizuar deri në momentin e aplikimit në formatin Europass;
- c. Fotokopjen e letërnjoftimit ose të pasaportës;
- d. Vërtetimin e dëshmisë së gjuhës së huaj;
- e. Vërtetimin e punësimit aktual, lëshuar nga institucioni përgjegjës, nëpërmjet titullarit;
- f. Vërtetimin për mësimdhënie, sipas afateve kohorë të parashikuar në kuadrin ligjor në fuqi;
- g. Vërtetimin nga institucioni për statusin e titullarit të lëndës/mbulimin e cikleve të plota të leksioneve;
- h. Vërtetim për udhëheqjen e doktoratave në rastin e aplikimit për titullin akademik "Profesor";
- i. Kopje të noterizuar të diplomës së gradës shkencore "Doktor" në rastin e aplikimit për titullin akademik "Profesor i Asociuar";
- j. Kopje të noterizuar të diplomës së gradës shkencore "Doktor" dhe titullit akademik "Profesor i Asociuar" në rastin e aplikimit për titullin akademik "Profesor";
- k. Listën e referimeve në konferencat shkencore të shoqëruara me programin dhe dokumentin që çertifikon pjesëmarrjen (çertifikatë, foto gjatë prezantimit, etj.). Në rastet kur konferenca ka botimin të punimeve të saj në proceedings (sipas nenit 17, pika 5 të kësaj Rregulloreje) me ISBN/ISSN, paraqitet dokumentacioni original ose fotokopje sipas specifikimeve të përfshira në skedën si dhe link-u i aksesueshëm për proceeding;
- l. Listën e botimeve të artikujve shkencorë të shoqëruar me botimet origjinale ose fotokopje dhe link-un e aksesueshëm, si dhe dëshminë e rankimit të revistës ndërkombëtare, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi;



- m. Monografinë ose monografitë (kur aplikanti paraqet më shumë se një monografi) të shoqëruar me botimet origjinale ose fotokopjen dhe link-un e aksesueshëm (nëse ka), si dhe dëshminë e rankimit të shtëpisë botuese sipas përcaktimeve në kuadrin ligjor në fuqi.
- n. Listën e pjesëmarrjes në komitete shkencore, botuese, projekte kërkimore, vlerësime të projekteve, projekte të transferimit teknologjik të patentave, të shoqëruar me dokumentet që vërtetojnë pjesëmarrjen dhe produktin (outputin) e realizuar, vërtetuar nga drejtuesit e komiteteve, revistave, projekteve dhe nga dokumentet e plota të produktit të realizuar si kontribut i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i aplikantit, sipas formularit të hartuar për këtë qëllim nga KPPA-ja;
- o. Dëshmi për studime postdoktorate në një nga vendet anëtare të BE, OECD ose G20, sipas përcaktimeve në kuadrin ligjor në fuqi, shoqëruar me raportin e detajuar për aktivitetin kërkimor-shkencor të zhvilluar gjatë periudhës përkatëse, të konfirmuar nga drejtuesi i studimeve postdoktorale dhe dokumentin që tregon për produktin dhe/ose rezultatin e studimeve postdoktorale të aplikantit;
- p. Evidencë të publikimeve të nxjerrë nga “Scopus Author”, për publikime në revista të indeksuara në Scopus, dhe/ose nga Web Science, për publikime në revista të indeksuara në Web of Science;
- q. 2 (dy) kopje elektronike e të gjithë dokumentacionit që përmban dosja në 2 (dy) CD ose në 2 (dy) memory stick, apo mjet tjetër të ruajtjes elektronike të të dhënave. 1 (një) nga kopjet elektronike të dosjes arkivohet në njësinë kryesore, ndërsa kopja tjetër është pjesë përbërëse dhe ruhet në dosjen e kandidatit.
- r. Në momentin e dorëzimit të dosjes pranë Njesisë Kryesore, kandidati pajiset me një dokument të protokolluar që vërteton datën e dorëzimit. Një kopje e këtij dokumenti futet në dosje.

Neni 23

Të drejtat dhe detyrimet e kandidatit për fitimin e titullit akademik

1. Të drejta të kandidatit

- a. të paraqesë kërkesën dhe dosjen për fitimin e titullit në përputhje me aktet ligjorë, nënligjorë në fuqi dhe kërkesave të përshkruara në këtë rregullore;
- b. të kërkojë informacion për ecurinë e procedurës së aplikimit dhe vlerësimit;
- c. të kërkojë informacion për vendimet e marra në lidhje me aplikimin nga të gjithë nivelet;
- d. të kërkojë të informohet dhe të ankohet, nëse është nevoja, në lidhje me procedurat dhe vendimet e marra për fitimin e titullit;
- e. të riaplikojë për fitimin e titullit përkatës brenda afatit kohor të parashikuar në fuqi, respektivisht brenda 6 (gjashtë) muajve nga refuzimi nga njësia bazë, ose pas një periudhe jo më të shkurtër se 2 (dy) vite nga refuzimi nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik.
- f. Të tërheqë në çdo moment kërkesën e tij për fitimin e titullit akademik. Në këtë rast me kërkesë të kandidatit atij i kthehet e gjitha dosja.

2. Detyrime të kandidatit



- a. të respektoje kërkesat në aktet ligjorë, nënligjorë dhe në këtë rregullore, dhe ato etike në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e dokumentacionit të aplikimit për titujt akademike "Profesor" dhe "Profesor i Asociuar";
- b. të respektojë procedurat për fitimin e titullit;
- c. të respektojë afatet e procedurave;
- d. të dërgojë dokumentacionin shtesë ose plotësues që kërkohet nga KPPA-ja brenda afateve të përcaktuara ligjore.
- e. të paguajë tarifën për shërbimin e kryer, sipas vendimit të Bordit të Administrimit.
- f. Të plotësojë dosjen sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe përcaktimeve përkatëse të KPPA-së.

Neni 24

Detyrat e njësisë kryesore dhe njësisë bazë

1. Detyra të njësisë kryesore

- a. Drejtuesi i njësisë kryesore pranon aplikimet për titujt akademikë nga kandidatët, sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore dhe kësaj rregulloreje dhe ia përcjell për vlerësim njësisë bazë brenda 20 (njëzet) ditëve.
- b. Brenda 5 (pesë) ditëve, nga marrja e dosjes së vlerësuar nga njësia bazë, drejtuesi i njësisë kryesore i përcjell me shkresë Kryetarit të Senatit Akademik, dosjen e plotë të kandidatit që ka aplikuar, së bashku me vendimin e njësisë bazë; relacionin e relatorëve dhe në rastet kur kërkohet ekuivalentim dhe raportin për angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit për veprimtaritë e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi dhe këtë Rregullore; si edhe 2 (dy) CD/memory stick apo format tjetër elektronik i ruajtjes së të dhënave, të paeditueshme, ku përfshihet dokumentacioni i plotë i aplikimit të kandidatit. Vetëm relacionet edhe skeda përcillen edhe në versionin e editueshëm (Ëord ose Excel).
- c. Në rastin kur njësia bazë ka dhënë vlerësim negativ, drejtuesi i njësisë kryesore i kthen kandidatit dosjen me materialet e printuar, vendimin përkatës për vlerësimin negativ, ndërsa njëra nga CD-të/memory stick, ose tjetër mjet elektronik i depozitimit të të dhënave të dosjes, arkivohet.
- d. Drejtuesi i njësisë kryesore pas marrjes nga Rektori të kërkesës së Komisionit për përcjelljen e propozimit për anëtarët e Jurisë për vlerësimin e dosjes, përcjell te Rektori i UT-së propozimin përkatës sipas rregullimeve në pikën 7, neni 25, kreu IV, të kësaj rregulloreje.
- e. Drejtuesi i njësisë kryesore pas marrjes nga Juria të Raportit të Jurisë për vlerësimin e veprimtarisë shkencore dhe pedagogjike të aplikantit për titullin Profesor i Asociuar/Profesor, brenda 5 (pesë) ditëve ia përcjell Rektorit të UT për të vijuar procedurat me përcjelljen në KPPA.
- f. Drejtuesi i njësisë kryesore i drejton Rektorit, për ta përcjellë në KPPA, kërkesën kur anëtari i jurisë heq dorë nga anëtarësia në juri shoqëruar me arsyetimin e dorëheqjes.

2. Detyra të njësisë bazë



Njësia bazë brenda 40 (dyzet) ditëve kalendarike, nga data e marrjes në dorëzim të dosjes së kandidatit, vlerëson dosjen e kandidatit për titullin akademik "Profesor" ose "Profesor i Asociuar" dhe vlerësimin e saj e përcjell tek drejtuesi i njësisë kryesore.

Vlerësimi i dosjeve të kandidateve bëhet në përputhje me kriteret dhe standardet shtetërore të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, si dhe bazuar në këtë Rregullore.

Procedura e vlerësimit të dosjes:

- a. Pas marrjes së dosjes në dorëzim, drejtuesi i njësisë bazë cakton 2 (dy) relatorë për të përgatitur relacionin në lidhje me përmbushjen e kriterëve dhe standardeve shtetërore për titullin akademik përkatës nga kandidati që ka aplikuar për fitimin këtij titulli.
Caktimi i relatorëve bëhet bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - i. si rregull, relatorët duhet të jenë personel akademik me kohë të plotë të njësisë bazë ku shqyrtohet dosja. Nëse nuk ka personel akademik që përmbush kriteret për të qenë relator, njësia bazë ka të drejtë të propozojë si të tillë, anëtarë të personelit akademik të njësive të tjera bazë të njësisë kryesore ose të njësive të tjera bazë të njësive të tjera kryesore të UT-së, të së njëjtës fushë ose të ngjashme me atë të kandidatit;
 - ii. Relatorët për kandidatin që aplikon për titullin akademik "Profesor i Asociuar" duhet të mbajnë titullin akademik "Profesor" dhe/ose "Profesor i Asociuar";
 - iii. Relatorët për kandidatin që aplikon për titullin akademik "Profesor", duhet të mbajnë titullin akademik "Profesor";
 - iv. Relatorët, si rregull, për zgjidhen të së njëjtës fushë ose fushave të ngjashme me atë të kandidatit që aplikon për titullin përkatës;
 - v. Relatorët propozohen nga drejtuesi i njësisë bazë dhe miratohen nga njësia bazë.
- b. Relatorët e njësisë bazë përgatitin relacionin e raportimit për përmbushjen e standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë nga kandidati, sipas formatit bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe nënshkruajnë në çdo faqe të relacionit të tyre.
- c. Njësia bazë, bazuar në relacionin e relatorëve dhe kriteret e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore dhe në këtë rregullore, **kur kërkohet ekuivalentim** përgatit raportin për angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit për veprimtaritë e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi dhe këtë Rregullore. Bazuar në këtë dokument njësia bazë merr vendim miratues ose refuzues me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të saj.
- d. Pas marrjes së vendimit për vlerësimin e dosjes së kandidatit që ka aplikuar për titullin akademik përkatës, njësia bazë i dërgon drejtuesit të njësisë kryesore, me shkresë përcjellëse, vendimin e saj, relacionin e firmosur nga të dy relatorët, **kur kërkohet ekuivalentim edhe** raportin për angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit për veprimtaritë e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi dhe këtë Rregullore, si dhe dokumentacionin origjinal të printuar të dosjes së kandidatit dhe 2 (dy) kopjet elektronike të të gjithë dokumentacionit të dosjes përfshirë përfshirë dhe relacionet dhe raportin e njësisë bazë, të regjistruar në CD/ memory stick ose në një mjet tjetër elektronik të paeditueshëm.



Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik

1. Komisioni shqyrton vetëm dosjet e kandidatëve që kanë marrë miratimin pozitiv nga njësia bazë.
2. Dokumentacioni i kandidatëve shqyrtohet sipas radhës së mbërritjes së tyre në Komision.
3. Pas përcjelljes së dosjes nga Kryetari i Senati Akademik në KPPA, Kryetari i Komisionit përzgjedh nga anëtarët e këtij Komisioni dy relatorë, të cilët përgatitin dhe paraqesin një relacion me shkrim, nëse dosja e dorëzuar është e plotë, si dhe shprehen në lidhje me përmbushjen, nga kandidati që ka aplikuar, të kërkesave formale për titullin akademik. Relatorët bëjnë një vlerësim përfundimtar të përgjithshëm të dosjes së paraqitur, pa hyrë në përmbajtjen e detajuar të elementeve të saj. Gjatë hartimit të relacionit, për çdo paqartësi të mundshme, relatorët kanë të drejtë të komunikojnë me njësinë bazë të njësisë kryesore, e cila ka kryer vlerësimin sipas nenit 24, pika 2 të kësaj Rregulloreje.
4. Relacioni përgatitet sipas formatit të miratuar nga Komisioni (formati bashkëlidhur) dhe nënshkruhet nga relatorët në çdo faqe.
5. Kur relatorët konstatojnë se, dokumentacioni në dosje është i paplotë, kandidati njoftohet në rrugë shkresore dhe/ose elektronike për të bërë plotësimet e nevojshme brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga konfirmimi i marrjes dijeni të njoftimit. Sipas nenit 17 pika 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje do të konsiderohen botime shkencore dhe konferenca të vlefshme ato që janë dorëzuar pranë njësisë kryesore deri në datën e aplikimit për fitimin e titullit të kërkuar. Në rast se, nuk kryhen plotësimet e kërkuara, dosja përcillet pranë drejtuesit të njësisë kryesore ku kandidati ka aplikuar, i cili ia kthen kandidatit. Dokumentacioni i aplikimit fillestar, mbahet në arkiva në formë elektronike.
6. Kur konstaton se dosja është e plotë, Komisioni procedon me përcjelljen e kërkesës për propozimin e Jurisë për vlerësimin e dosjes Rektorit të UT-së për përcjellje në njësinë kryesore.
7. Propozimi për anëtarët e jurisë duhet të respektojë këto kritere:
 - a. jo më pak se 8 (tetë) kandidatë me titullin akademik "Profesor, nga të cilët:
 - i. 5 (pesë) kandidatë kërkohet të jenë nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore të Universitetit të Tiranës të së njëjtës fushë, ose fushave të ngjashme me atë të kandidatit dhe/ose në mungesë nga njësitë e tjera kryesore të Universitetit të Tiranës, që mbulojnë fusha të përafërta me njësinë kryesore, ndërsa
 - ii. 3 (tre) kandidatë kërkohet të jenë nga personeli akademik i institucioneve të tjerë të arsimit të lartë (IAL) me kohë të plotë, të së njëjtës fushë ose fushave të ngjashme me atë të kandidatit.
 - b. të paktën, 2 (dy) anëtarë të jurisë duhet të jenë të së njëjtës fushë me atë të kandidatit, ndërsa 3 (tre) nga fusha të ngjashme me atë të kandidatit.
 - c. relatorët e dosjes nga njësia bazë me titullin akademik "Profesor", mund të përfshihen në kandidatët për anëtarë jurie.

Neni 26

Ngritja dhe funksionimi i jurisë për vlerësimin e kandidatit



- a. Ngritja e jurisë për vlerësimin e dosjes së kandidatit kryhet nga Komisioni, i cili përzgjedh pesë anëtarë nga 8 (tetë) kandidaturat e propozuara nga njësia bazë dhe aprovuara nga drejtuesi i njësive kryesore.
- b. Juria përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë që mbajnë titullin akademik "Profesor" nga e njëjta fushë ose nga fusha të ngjashme me atë të kandidatit, prej të cilëve, 3 (tre) janë personel akademik me kohë të plotë, të njësive kryesore të Universitetit të Tiranës nga vjen kandidati dhe/ose i njësive të tjera kryesore të Universitetit të Tiranës që mbulojnë fusha të përafërta dhe 2 (dy) janë nga institucione të tjerë të arsimit të lartë, vendas ose të huaj. Të paktën dy anëtarë të Jurisë janë të së njëjtës fushë me atë të kandidatit.
- c. Komisioni zgjedh prej anëtarëve të jurisë kryetarin e saj duke mbajtur parasysh si rregull këto kritere:
- është anëtar i personelit akademik me kohë të plotë i UT-së;
 - është nga e njëjta fushë studimi me kandidatin;
 - mund të kryesojë jo më shumë se deri në dy juri njëkohësisht.
- d. Data e nisjes së procedurës së vlerësimit të kandidatit konsiderohet data e ngritjes së Jurisë.
- e. Brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e nisjes së procedurës së vlerësimit Juria përgatit Raportin e Jurisë për vlerësimin e veprimtarisë shkencore dhe pedagogjike të aplikantit për titullin Profesor i Asociuar/Profesor në përfundim të së cilit jepet edhe rekomandimi për dhënien ose jo të titullit akademik, duke ndjekur këto hapa:
- i. Kryetari i jurisë pasi njoftohet për vendimin e ngritjes së Jurisë, i dërgon anëtarëve të jurisë në formë elektronike dokumentacionin e kandidatit; cakton 2 (dy) anëtarë të jurisë të përgatisin raportin e vlerësimit; drejton mbledhjen për marrjen e vendimit.
 - ii. Juria organizon punën për të mundur që, kandidati të realizojë prezantimin sipas përcaktimeve të pikës 10, të nenit 17, Kreu III të kësaj rregullore.
 - iii. Raporti i Jurisë për vlerësimin e veprimtarisë shkencore dhe pedagogjike të aplikantit për titullin Profesor i Asociuar/Profesor përgatitet brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e marrjes nga anëtarët e jurisë të njoftimit për vendimin e ngritjes së Jurisë. Raporti i Jurisë për vlerësimin e veprimtarisë shkencore dhe pedagogjike të aplikantit për titullin Profesor i Asociuar/Profesor i dërgohet në formë elektronike të gjithë anëtarëve të jurisë për mendim. Ky raport duhet të jetë i argumentuar. Ai hartohet sipas formatit të raportit dhe të skedës përmbledhëse të plotësimit të kriterëve që i bashkëngjitet kësaj rregulloreje. Ky raport duhet të paraqesë me qartësi dhe saktësi përmbledhjen e kriterëve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, në lidhje me aspektin formal dhe atë përmbajtësor dhe cilësor e shkencor të këtyre kriterëve. Juria duhet të vlerësojë dhe vërtetojë me saktësi duke verifikuar apo shënuar edhe link-et e artikujve dhe referimeve të paraqitura në dosje, të vlerësojë dhe të shprehet qartë edhe në lidhje me përmbajtjen cilësore dhe origjinalitetin e punimeve të paraqitura, vërtetësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të paraqitur në dosje, të shprehet dhe vlerësojë në mënyrë të dokumentuar edhe mbi ekuivalentimet e monografisë dhe aktivitetëve e angazhimeve të tjera të kandidatit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi dhe kësaj rregulloreje dhe manualit bashkëlidhur asaj.
 - iv. Pasi përfundon diskutimin për Raportin e Jurisë për vlerësimin e veprimtarisë shkencore dhe pedagogjike të aplikantit për titullin Profesor i Asociuar/Profesor,



- juria miraton variantin përfundimtar të tij dhe jep rekomandimin për dhënien ose refuzimin e titullit akademik, të kërkuar nga kandidati.
- v. Raporti i Jurisë për vlerësimin e veprimtarisë shkencore dhe pedagogjike të aplikantit për titullin Profesor i Asociuar/Profesor dhe rekomandimi, hartohen sipas formatit të miratuar nga Komisioni.
 - vi. Juria i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore, në formë shkresore dhe elektronike (CD/Memory stick) Raportin e Jurisë për vlerësimin e veprimtarisë shkencore dhe pedagogjike të aplikantit për titullin Profesor i Asociuar/Profesor dhe rekomandimin.
- f. Juria funksionon si organ kolegjal dhe përgjegjësinë e mban në mënyrë kolegjiale.
 - g. Në rastin kur anëtari i jurisë nuk ka të njëjtin vlerësim me pjesën tjetër të saj, ai harton një raport të veçantë, i cili i bashkëngjitet Raportit të Jurisë për vlerësimin e veprimtarisë shkencore dhe pedagogjike të aplikantit për titullin Profesor i Asociuar/Profesor të pjesës tjetër të jurisë.
 - h. Raporti i Jurisë për vlerësimin e veprimtarisë shkencore dhe pedagogjike të aplikantit për titullin Profesor i Asociuar/Profesor miratohet me shumicën e anëtarëve të jurisë.
 - i. Anëtarët e jurisë mbajnë përgjegjësi ligjore dhe etike, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, për vërtetësinë e të dhënave të përfshira në Raportin e tyre për vlerësimin e veprimtarisë shkencore dhe pedagogjike të aplikantit për titullin Profesor i Asociuar/Profesor.
 - j. Raporti i Jurisë për vlerësimin e veprimtarisë shkencore dhe pedagogjike të aplikantit për titullin Profesor i Asociuar/Profesor dhe rekomandimi nënshkruhet nga anëtarët dhe kryetari i jurisë.

Neni 27

Vlerësimi i kandidatit nga KPPA

1. Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik merr vendim përfundimtar për miratimin ose refuzimin e kërkesës së kandidatit, pas marrjes së Raportit të Jurisë për vlerësimin e veprimtarisë shkencore dhe pedagogjike të aplikantit për titullin Profesor i Asociuar/Profesor.
2. Dy relatorët e mëparshëm të dosjes, të zgjedhur nga anëtarë e KPPA-së, relatojnë përpara Komisionit lidhur me Raportin e Jurisë për vlerësimin e veprimtarisë shkencore dhe pedagogjike të aplikantit për titullin Profesor i Asociuar/Profesor dhe vendimin e jurisë.
3. Komisioni merr vendimin përfundimtar bazuar në vendimin dhe Raportin e Jurisë për vlerësimin e veprimtarisë shkencore dhe pedagogjike të aplikantit për titullin Profesor i Asociuar/Profesor dhe në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur.
4. Komisioni i përcjell Rektorit të Universitetit të Tiranës, vendimin për vlerësimin e kandidatit.

Neni 28

Konflikti i interesit dhe çështjet e etikës



1. Konflikti i interesit lind nga një rrethanë, në të cilën vlerësuesi mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij.

2. Papajtueshmëria e anëtarit të KPPA-së ndodh:

- a. kur anëtari i KPPA-së është propozuar nga njësia kryesore në jurinë për vlerësimin e kandidatit;
- b. kur anëtari i KPPA-së është propozuar nga njësia bazë, si relator për vlerësimin e dosjes në njësinë bazë;
- c. kur anëtari i propozuar i jurisë ka lidhje familjare deri në shkallë të dytë me kandidatin që vlerësohet;
- d. kur relatori/anëtari i jurisë ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë me vendimmarrjen në shqyrtim;
- e. në raste të tjera, sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative.

3. Kur një anëtar i KPPA-së, ka qënë anëtar i jurisë së aplikantit për titullin "Profesor" ose "Profesor i Asociuar", ai nuk mund të jetë relator në KPPA për këtë kandidat, dhe as duhet të votojë për kandidatin në fjalë.

4. Në momentin kur anëtari i propozuar për pjesëmarrje në juri ose si relator, konstaton papajtueshmëri me detyrën e caktuar, ka detyrimin të bëjë deklarinimin me shkrim dhe të kërkojë tërheqjen e kandidaturës së tij.

5. Në rastin kur anëtari i jurisë heq dorë nga anëtarësia në juri, njofton drejtuesin e njësisë kryesore duke argumentuar dorëheqjen. Komisioni e zëvendëson atë me njërin prej anëtarëve të tjerë nga 8 (tetë) propozimet e paraqitura nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe të miratuara nga Rektori i Universitetit të Tiranës.

Neni 29

Regjistrimi i titullit akademik

1. Rektori i Universitetit të Tiranës i përcjell zyrtarisht AKKSHI-t, kërkesën për regjistrimin e titullit akademik në regjistrin shtetëror të titujve akademikë.

2. Titulli akademik regjistrohet në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), si dhe në regjistrin institucional të titujve akademikë të Universitetit të Tiranës.

3. Diploma e titullit akademik, sipas formës dhe elementëve të miratuar nga Senati Akademik, lëshohet nga Universiteti i Tiranës dhe nënshkruhet nga Rektori.

4. Universiteti i Tiranës mban Regjistrin Institucional për Titullin Akademik "Profesor i Asociuar" dhe Regjistrin Institucional për Titullin Akademik "Profesor", i cili plotësohet dhe administrohet nga sekretari teknik i KPPA- së. Këta Regjistra duhet përmbajnë të paktën, këto të dhëna:

- i. Numri i regjistrit institucional;



- ii. Emërtimi i regjistrit institucional;
- iii. Numri i regjistrimit në regjistrin institucional të titullit akademik;
- iv. Emër, atësi dhe mbiemër të personit, të cilit i jepet titulli akademik;
- v. Gjinia;
- vi. Datëlindja;
- vii. Shtetësia;
- viii. Institucioni nga vjen kandidati që fiton titullin;
- ix. Numri dhe data e vendimit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik;
- x. Data e regjistrimit në regjistër të titullit akademik;
- xi. Fusha e studimit;
- xii. Numri i regjistrit në Regjistrin Shtetëror të Gradave Shkencore dhe Titujve Akademikë pranë AKKSHI-t;
- xiii. Nënshkrimi i marrësit të diplomës (nëse nga marrësi i titullit është lëshuar Prokurë e Posaçme për këtë qëllim, depozitohet një kopje origjinale e saj dhe nënshkruan në regjistër përfaqësuesi i caktuar me Prokurë);
- xiv. Data e tërheqjes së diplomës.

5. Plotësimi i të dhënave në Regjistrat Institucionalë për titujt akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", bëhet nga Sekretari Teknik i KPPA-së.

6. Shpërndarja e diplomave kryhet nga Sekretari Teknik i KPPA-së.

7. Tërheqja e diplomës bëhet nga kandidati, ose përfaqësuesi i tij, i caktuar me Prokurë.

8. Përpara tërheqjes, kandidati, ose përfaqësuesi i tij me prokurë të posaçme, verifikon të dhënat e dokumentit të titullit dhe nënshkruan në regjistrin përkatës të institucionit, për tërheqjen e dokumentit.

9. Pas tërheqjes me firmë të diplomës nga kandidati ose përfaqësuesi i tij me prokurë të posaçme, nuk procedohet më me prodhimin e një diplome tjetër origjinale. Institucioni në këtë rast lëshon vetëm vërtetim për marrjen e titullit.

Neni 30

Ankimi për vendimin e vlerësimit

1. Çdo kandidat gëzon të drejtën e ankimit ndaj vendimeve dhe procedurave të ndërmjetme të njësisë bazë, njësisë kryesore dhe Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, në lidhje me zbatimin e procedurave të ndjekura prej tyre, deri para marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionit.

2. Kandidati mund të paraqesë ankim nëse vendimi është nxjerrë:

- a. si rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën e marrjes së vendimeve nga njësi kryesore, njësi bazë, Komisioni;
- b. si rezultat i zbatimit të gabuar të akteve ligjore dhe nënligjore, vendimi nuk është i bazuar në fakte dhe provat e paraqitura.



3. Ankimi paraqitet brenda 1 (një) muaji, nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi për njësinë bazë/kryesore i drejtohet KPPA-së. Komisioni ngre një komision ad hoc me përbërjen e anëtarëve të saj, të përbërë prej 3 (tre) anëtarësh që mbajnë titullin "Profesor". Komisioni *ad hoc* shqyrton ankesën, bën verifikimin dhe përgatit relacionin që ia paraqet Komisionit. Nëse e vlerëson, komisioni *ad hoc*, dëgjon edhe ankuesin në një seancë dëgjimore. Komisioni shqyrton ankimin dhe merr vendim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga paraqitja e tij. Vendimi i Komisionit, pas shqyrtimit të ankimit, është përfundimtar dhe i njoftohet zyrtarisht ankimuesit nga Kryetari.
5. Ankimi për Komisionin i drejtohet Kryetarit të Senatit Akademik. Senati ngre një komision *ad hoc* me përbërjen e anëtarëve të saj, të përbërë prej 3 (tre) anëtarësh që mbajnë titullin "Profesor". Komisioni *ad hoc* shqyrton ankesën, bën verifikimin dhe përgatit relacionin që ia paraqet Senatit. Nëse e vlerëson, komisioni *ad hoc*, dëgjon Komisionin edhe ankuesin në një seancë dëgjimore. Senati shqyrton ankimin dhe merr vendim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga paraqitja e tij. Vendimi i Senatit, pas shqyrtimit të ankimit, është përfundimtar dhe i njoftohen zyrtarisht Komisionit për zbatim nga Kryetari i Senatit.

Neni 31 **Shfuqizimi i titujve akademikë**

1. Titulli akademik mund të shfuqizohet në rastet kur vërtetohet se, në veprimtarinë shkencore të kandidatit (artikull shkencor, referim në konferenca, monografi të botuar, ose ekuivalentime të kërkuara nga kandidati, etj.), e cila ka shërbyer për promovimin e tij për titull akademik, konstatohen sjellje dhe praktika të papranueshme, në kundërshtim me parimet e etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor, konkretisht:

- a. Fabrikim-sajim i rezultateve dhe regjistrimi i tyre sikur të ishin të vërteta;
- b. Falsifikim-manipulim i materialeve të kërkimit, pajisjeve apo proceseve ose ndryshimi, heqja apo shmangia e të dhënave apo rezultateve pa justifikim;
- c. Plagjiaturë-përdorim i ideve dhe punës së të tjerëve pa ia njohur vlerën burimit origjinal, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale.

2. Titulli akademik mund të shfuqizohet edhe kur vërtetohet se, kandidati ka paraqitur të dhëna të pavërteta, ose i ka falsifikuar ato, me qëllim përmbushjen e standardeve të përcaktuar nga vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave, për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar dhe/ose "Profesor". Vendimi për shfuqizimin merret vetëm pasi të jenë ndjekur procedurat administrative sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative.

3. Barra e provës për të provuar akuzat mbi plagjiaturën ose manipulimin e të dhënave në punimet e kandidatit bie mbi subjektin që ka ngritur akuzën.

4. Vendimi merret me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik të Universitetit të Tiranës, pas rekomandimit të dhënë nga komisioni i posaçëm, i



caktuar nga Senati Akademik, i përbërë nga të paktën 3 (tre) anëtarë të Senatit Akademik, të cilët mbajnë titullin akademik "Profesor", të së njëjtës fushë ose fushave të përafërta.

5. Përpara marrjes së vendimit, komisioni i posaçëm njofton personin ndaj të cilit ka filluar procedimi:

- a. për akuzat e ngritura sipas pikës 1 dhe/ose 2 të këtij neni;
- b. për të drejtën që ai ka për të paraqitur, me shkrim, sqarimet e tij rreth akuzës së ngritur, si dhe një afat të arsyeshëm, deri kur duhet të paraqitet ky sqarim;
- c. për të drejtën që ka për të inspektuar dosjen e procedimit, për t'u dëgjuar, ai vetë apo me përfaqësues ligjor, për të paraqitur dëshmitarë, për të paraqitur prova ose për të kërkuar marrjen e tyre.

6. Pasi komisionit të posaçëm t'i jetë vënë në dispozicion informacioni i kërkuar sipas germës b të pikës të kësaj dispozite, ky i fundit njofton personin ndaj të cilit ka filluar procedimi, për datën kur do të shqyrtohet akuza e pretenduar, e cila nuk mund të caktohet më shpejt se 5 (pesë) ditë pune dhe jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune, nga marrja e njoftimit.

7. Procesi i verifikimit kryhet në mënyrë të paanshme, gjithëpërfshirëse, pa cënuar saktësinë dhe objektivitetin e procedimit.

8. Palët e përfshira në procedimin administrativ, deklarojnë çdo konflikt interesi që mund të dalë gjatë verifikimit. Procedurat kryhen në mënyrë konfidenciale, me qëllim mbrojtjen e personave, që janë të përfshirë në verifikim.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 32 Veprimtaria në distance (online)

1. Në rast të pamundësisë së zhvillimit të mbledhjeve të Komisionit, të njësisë bazë dhe të jurisë me pjesëmarrje fizike, është i vlefshëm zhvillimi i veprimtarisë online. Në këto raste shënohet në procesverbal mënyra e mbajtjes së mbledhjes dhe vendimet zbardhen në formë shkresore.

2. Në rast të pamundësisë së pjesëmarrjes fizike në mbledhje, anëtari i KPPA-së, i njësisë bazë, i jurisë mund të shprehë mendimin e tij dhe të votojë online. Pas votimit online, e dërgon mendimin dhe votën e vet me postë elektronike. Ky e-mail duhet të shpërndahet te të gjithë anëtarët e tjerë të Komisionit, njësisë bazë, jurisë dhe përfshihet në procesverbalin e mbledhjes.

Neni 33 Efektet financiare dhe shpërblymimi i anëtarëve

1. Anëtarët e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik paguhen për punën e kryer për dhënien e titujve akademikë, sipas vendimit të Bordit të Administrimit.



2. Anëtarët e jurisë për vlerësimin e dosjes së kandidatit për titullin akademik të kërkuar, paguhen sipas vendimit të Bordit të Administrimit.
3. Anëtarët e jurisë me vendbanim jashtë Tiranës dhe nga jashtë vendit, paguhen për shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit, sipas vendimit të Bordit të Administrimit.
4. Kandidatët që kërkojnë të promovohen për fitimin e një titulli akademik, i nënshtrohen tarifës për shërbimin e kryer, sipas vendimit të Bordit të Administrimit.

Neni 34 **Kontrolli i veprimtarisë**

Veprimtaria administrative e KPPA-së i nënshtrohet:

- a. kontrollit administrativ, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative mbi mjetet ligjore administrative dhe legjislacionit në fuqi;
- b. çdo kontrolli tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 35 **Miratimi, hyrja në fuqi dhe ndryshimi i rregullores**

1. Kjo rregullore miratohet me vendim të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës dhe hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.
2. Kjo Rregullore i shtrin efektet për kërkesat që do të paraqiten për promovim në KPPA, pas hyrjes në fuqi të saj.
3. Kandidatët, të cilët kanë filluar procedurën për marrjen e titujve akademikë dhe janë në shqyrtim nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik e mbyllin procedurën për marrjen e titullit akademik, sipas kritereve të legjislacionit në fuqi, në momentin e dorëzimit të dosjes pranë drejtuesit të njësisë kryesore.
4. Të drejtën e ndryshimeve në këtë rregullore e ka Senati Akademik i Universitetit të Tiranës.
5. Propozimet për ndryshime mund të vijnë nga anëtarët e Senatit Akademik të UT-së, Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, nga Rektorati, njësitë kryesore dhe njësitë bazë, të Universitetit të Tiranës.
6. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA) dhe procesit për fitimin e titujve akademikë në Universitetin e Tiranës", miratuar me Vendimin nr. 21, datë 27.07.2022 të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, shfuqizohet.

KRYETARI
Prof. Dr. Artan Hoxha



MANUAL

Mbi ekuivalentimin e veprimtarive akademiko – didaktike të kandidatëve në kërkim të fitimit të titullit akademik

I. Treguesit cilësorë dhe sasiorë për ekuivalentimin e veprimtarive akademiko – didaktike në kërkim të fitimit të titullit akademik “Profesor i Asociuar”

Për efekt të promovimit akademik, merret në konsideratë angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit, që kërkon titullin akademik **“Profesor i Asociuar”**, pas marrjes së gradës shkencore “Doktor”, në veprimtari akademiko-didaktike të ndryshme, të cilat vlerësohen nëse përmbushin kriterin e kualifikimit për t’u vlerësuar me treguesit cilësorë dhe sasiorë të konvertimit sipas nenit 18 pika 2 të kësaj rregulloreje, si më poshtë:

(a) Në rastet kur plotësohen se paku 4 veprimtari të ndryshme të nenit 18 pika 2 të kësaj rregulloreje, vlerësimi për qëllime të ekuivalentimit është:

1 (një) artikull shkencor, i botuar në revistë shkencore ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI), ose

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje dhe **2 (dy) referime** mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(b) pjesëmarrja në komitete shkencore apo redaktuese, për të cilat vlerësimi kryhet si më poshtë:

(i) Kandidati ka marrë pjesë në së paku, 2 (dy) komitete shkencore apo redaktuese të 2 (dy) konferencave shkencore kombëtare, ku të ketë vlerësuar, redaktuar apo kryer peer review për të paktën 2 (dy) referime në secilën konferencë. Kur ky aktivitet dokumentohet me vërtetimin e institucionit përgjegjës për organizimin e konferencës, shoqëruar me produktet e redaktimit apo peer review që ka kryer, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(ii) Kandidati ka marrë pjesë në së paku, 2 (dy) komitete shkencore apo redaktues të 2 (dy) konferencave shkencore ndërkombëtare, të zhvilluara në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, ku të ketë vlerësuar, redaktuar apo kryer peer review të paktën për 2 (dy) referime në secilën konferencë. Kur ky aktivitet dokumentohet me vërtetimin e institucionit përgjegjës për organizimin e konferencës, shoqëruar me produktet e redaktimit apo peer review që ka kryer, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.



(c) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose jo periodikeve shkencorë, për të cilat vlerësimi kryhet si më poshtë:

(i) Kandidati ka kryer veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të të paktën 2 (dy) periodikëve ose jo periodikëve shkencorë kombëtare, ku të ketë vlerësuar, apo redaktuar jo më pak se 2 (dy) artikuj për çdo periodik shkencor kombëtar. Ky aktivitet i dokumentuar me vërtetimin e organit përgjegjës drejtues të periodikut apo jo periodikut dhe i pranuar nga njësia bazë shoqëruar me vlerësimet apo redaktimet që kandidati ka kryer, kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(ii) Kandidati ka kryer veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të të paktën 2 (dy) periodikëve ose jo periodikëve shkencorë ndërkombëtarë, ku të ketë vlerësuar, apo redaktuar jo më pak se 2 (dy) artikuj për çdo periodik shkencor. Ky aktivitet i dokumentuar me vërtetimin e organit përgjegjës drejtues të periodikut apo jo periodikut dhe të pranuar nga njësia bazë shoqëruar me vlerësimin apo redaktimin që kandidati ka kryer, kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(d) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtar, për të cilat vlerësimi kryhet si më poshtë:

(i) Kandidati ka qenë angazhuar dhe ka marrë pjesë në të paktën 1 (një) projekt kërkimor-shkencor kombëtar në nivel drejtuesi apo koordinatori, ose në të paktën 2 (dy) projekte kërkimore shkencore në nivel anëtar, të dokumentuar me vërtetimin e njësisë apo njësive që kanë organizuar projektin, ku evidentohet roli i kandidatit si drejtues ose koordinator ose si anëtar, sipas niveleve sasiore të mësipërme, dhe konfirmuar me vlerësimin e njësisë bazë ku aplikon kandidati. Kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD- së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(ii) Kandidati ka qenë angazhuar dhe ka marrë pjesë në të paktën 1 (një) projekt kërkimor-shkencor ndërkombëtar në nivel drejtuesi apo koordinatori, ose në të paktën 2 (dy) projekte kërkimore-shkencore ndërkombëtare në nivel anëtar, të dokumentuar me vërtetimin e njësisë apo njësive që kanë organizuar projektin, ku evidentohet roli i kandidatit si drejtues ose koordinator ose si anëtar, sipas niveleve sasiore të mësipërme, dhe konfirmuar me vlerësimin e njësisë bazë ku aplikon kandidati. Kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

2 (dy) artikuj shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD- së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.



(e) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar, për të cilat vlerësimi kryhet si më poshtë:

(i) Kur kandidati ka kontribuar në përfitimin e të paktën 1 (një) financimi në bazë konkurrimi në nivel kombëtar, evidentuar me dokument të lëshuar nga financuesi ose përfituesi i financimit, për rolin organizator dhe drejtues të kandidatit, si dhe konfirmuar me vlerësimin e njësisë bazë/kryesore ku aplikon kandidati, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim të mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(ii) Kur kandidati ka kontribuar në përfitimin e të paktën 1 (një) financimi në bazë konkurrimi në nivel ndërkombëtar, evidentuar me dokumentin e lëshuar nga financuesi ose përfituesi i financimit, për rolin organizator dhe drejtues të kandidatit, si dhe konfirmuar me vlerësimin e njësisë bazë/kryesore ku aplikon kandidati, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(f) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin në rolin e koordinatorit të projektit, për të cilat vlerësimi kryhet si më poshtë:

(i) Kur kandidati ka kontribuar në sigurimin e të paktën 1 (një) financimi në bazë konkurimi në nivel kombëtar, i cili ka sjellë përfitim për institucionin në rolin e koordinatorit të projektit, i evidentuar me dokumentin e lëshuar nga donatori i huaj ose përfituesi i financimit për rolin e kandidatit si koordinator, si dhe vlerësimin e njësisë bazë/kryesore ku aplikon kandidati, mbi përfitimin institucional nga ky projekt dhe rolin e kandidatit në të, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(ii) Kur kandidati ka kontribuar në sigurimin e të paktën 1 (një) financimi në bazë konkurimi në nivel ndërkombëtar, i cili ka sjellë përfitim për institucionin në rolin e koordinatorit të projektit, i evidentuar me dokumentin e lëshuar nga donatori i huaj ose përfituesi i financimit për rolin e kandidatit si koordinator, si dhe vlerësimin e njësisë bazë/kryesore ku aplikon kandidati, mbi përfitimin institucional nga ky projekt dhe rolin e kandidatit në të, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

2 (dy) artikuj shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(g) pjesëmarrja në vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare, për të cilat vlerësimi kryhet si më poshtë:

(i) Kur kandidati ka marrë pjesë në vlerësimin e të paktën 1 (një) projekti kërkimor kombëtar, i dokumentuar me vërtetimin përkatës të financuesit të projektit për këtë vlerësim, shoqëruar me vlerësimin që ka kryer, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(ii) Kur kandidati ka marrë pjesë në vlerësimin e të paktën 1 (një) projekti kërkimor ndërkombëtar, i dokumentuar me vërtetimin përkatës të financuesit të projektit për këtë vlerësim shoqëruar me vlerësimin që ka kryer, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

2 (dy) artikuj shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(h) pjesëmarrja dhe angazhimi si drejtues në komitetet organizuese, për të cilat vlerësimi kryhet si më poshtë:

(i) Kur kandidati është angazhuar si drejtues **i komitetit organizues** në të paktën 2 (dy) konferenca shkencore kombëtare, ku të ketë bërë vlerësimin apo peer review për të paktën 1 (një) referim shkencor në secilën konferencë, i dokumentuar me vërtetimin e institucionit organizues dhe të pranuar nga njësia bazë, shoqëruar me vlerësimin apo peer review që ka kryer kandidati, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(ii) Kur kandidati ka qenë angazhuar si drejtues **i komitetit organizues** në të paktën 2 (dy) konferenca shkencore ndërkombëtare, ku të ketë bërë vlerësimin apo peer review për të paktën 1 (një) referim shkencor në secilën konferencë, i dokumentuar me vërtetimin e institucionit organizues dhe të pranuar nga njësia bazë, shoqëruar me vlerësimin apo peer review që ka kryer kandidati, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

2 (dy) artikuj shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(j) pjesëmarrja në projektet e transferimit teknologjik të patentave, për të cilat vlerësimi kryhet si më poshtë:

Kur kandidati ka marrë pjesë në projektet e transferimit teknologjik të patentave, vërtetuar kjo me dokumentacionin përkatës lëshuar nga autoriteti përkatës ose vërtetimin që vërteton projektin e transferimit të teknologjisë, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, i botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore

ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit te Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI) dhe

1 (një) referim të mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20s, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në Proceedings (sipas nenit 17, pika 5 të kësaj Rregulloreje), të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(k) Në rastet kur kandidati ka realizuar studim post doktoratë në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, me një kohëzgjatje, të paktën, 6 (gjashtë) muaj, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të konfirmimit të PostDoc, me një raport të detajuar për aktivitetin kërkimor-shkencor të zhvilluar gjatë kësaj periudhe, i pranuar dhe vlerësuar nga njësia bazë e njësisë kryesore nga ku është nisur aplikanti, ekuivalentohet me:

1 (një) artikull shkencor, i botuar në revistë shkencore ndërkombëtare të indeksuara në Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi te Journal Citation Report (ICR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (ICI) dhe

1 (një) referim të mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

II. Treguesit cilësorë dhe sasiorë për ekuivalentimin e veprimtarive akademiko – didaktike në kërkim të fitimit të titullit akademik "Profesor"

Për efekt të promovimit akademik, merret në konsideratë angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit, që kërkon titullin akademik "**Profesor**", pas fitimit të titullit akademik "**Profesor i Asociuar**", në veprimtari akademiko-didaktike të ndryshme, të cilat vlerësohen nëse përmblin kriterin e kualifikimit për t'u vlerësuar me treguesit cilësorë dhe sasiorë të konvertimit sipas nenit 18 pika 3 të kësaj rregulloreje, si më poshtë:

(a) Në rastet kur plotësohen së paku 4 veprimtari të ndryshme të nenit 18 pika 2 të kësaj rregulloreje, vlerësimi për qëllime të ekuivalentimit është:

1 (një) artikull shkencor, i botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit te Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI), ose

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje **dhe 2 (dy) referime** të mbajtura në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(b) pjesëmarrja në komitete shkencore apo redaktuese, për të cilat vlerësimi kryhet si më poshtë:

(i) Kandidati ka marrë pjesë në së paku 3 (tre) komitete shkencore apo redaktuese të 3 (tre) konferencave shkencore kombëtare, ku të ketë vlerësuar, redaktuar apo kryer peer review për të paktën 3 (tre) referime në secilën konferencë. Kur ky aktivitet dokumentohet me vërtetimin e institucionit përgjegjës për organizimin e konferencës, shoqëruar me produktet e redaktimit apo peer review që ka kryer, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(ii) Kandidati ka marrë pjesë në së paku 3 (tre) komitete shkencore apo redaktuese të 3 (tre) konferencave shkencore ndërkombëtare, të zhvilluara në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, ku të ketë vlerësuar, redaktuar apo kryer peer review të paktën për 3 (tre) referime në secilën konferencë. Kur ky aktivitet dokumentohet me vërtetimin e institucionit përgjegjës për organizimin e konferencës, shoqëruar me produktet e redaktimit apo peer review që ka kryer, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(c) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose jo periodikëve shkencorë, për të cilat vlerësimi kryhet si më poshtë:

(i) Kandidati ka kryer veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të të paktën 3 (tre) periodikëve ose jo periodikëve shkencorë kombëtarë, ku të ketë vlerësuar, apo redaktuar jo më pak se 3 (tre) artikuj për çdo periodik shkencor kombëtar. Ky aktivitet i dokumentuar me vërtetimin e organit përgjegjës drejtues të periodikut apo jo periodikut dhe i pranuar nga njësia bazë shoqëruar me vlerësimet apo redaktimet që kandidati ka kryer, kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(ii) Kandidati ka kryer veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të të paktën 3 (tre) periodikëve ose jo periodikëve shkencorë ndërkombëtarë ku të ketë vlerësuar, apo redaktuar jo më pak se 3 (tre) artikuj për çdo periodik shkencor. Ky aktivitet i dokumentuar me vërtetimin e organit përgjegjës drejtues të periodikut apo jo periodikut dhe i pranuar nga njësia bazë shoqëruar me vlerësimet apo redaktimet që kandidati ka kryer, kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(d) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtar, për të cilat vlerësimi kryhet si më poshtë:

(i) Kandidati ka qenë angazhuar dhe ka marrë pjesë në të paktën 2 (dy) projekte kërkimore-shkencore kombëtare në nivel drejtuesi apo koordinatori, dhe në të paktën 3 (tre) projekte kërkimore shkencore në nivel anëtar, të dokumentuar me vërtetimin e njësive apo njësive që kanë organizuar projektin, ku evidentohet roli i kandidatit si drejtues ose koordinator ose si anëtar, sipas niveleve sasiore të mësipërme, dhe konfirmuar me vlerësimin e njësive bazë ku aplikon kandidati. Kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(ii) Kandidati ka qenë angazhuar dhe ka marrë pjesë në të paktën 2 (dy) projekte kërkimore-shkencore ndërkombëtare në nivel drejtuesi apo koordinatori, ose në të paktën 3 (tre) projekte kërkimore-shkencore në nivel anëtar, të dokumentuar me vërtetimin e njësisë apo njësive që kanë organizuar projektin, ku evidentohet roli i kandidatit si drejtues ose koordinator ose si anëtar, sipas niveleve sasiore të mësipërme, dhe konfirmuar me vlerësimin e njësisë bazë ku aplikon kandidati. Kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(e) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar, për të cilat vlerësimi kryhet si më poshtë:

(i) Kur kandidati ka kontribuar në përfitimin e të paktën 2 (dy) financimeve në bazë konkurrimi në nivel kombëtar, evidentuar me dokument të lëshuar nga financuesi ose përfituesi i financimit, për rolin organizator dhe drejtues të kandidatit, si dhe konfirmuar me vlerësimin e njësisë bazë/kryesore ku aplikon kandidati, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD- së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(ii) Kur kandidati ka kontribuar në përfitimin e të paktën 2 (dy) financimeve në bazë konkurrimi në nivel ndërkombëtar, evidentuar me dokumentin e lëshuar nga financuesi ose përfituesi i financimit, për rolin organizator dhe drejtues të kandidatit, si dhe konfirmuar me vlerësimin e njësisë bazë/kryesore ku aplikon kandidati, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD- së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(f) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit, për të cilat vlerësimi kryhet si më poshtë:

(i) Kur kandidati ka kontribuar në sigurimin e të paktën 2 (dy) financimeve në bazë konkurimi në nivel kombëtar, i cili ka sjellë përfitim për institucionin në rolin e koordinatorit të projektit, i evidentuar me dokumentin e lëshuar nga donatori i huaj ose përfituesi i financimit për rolin e kandidatit si koordinator, si dhe vlerësimin e njësisë bazë/kryesore ku aplikon kandidati, mbi përfitimin institucional nga ky projekt dhe rolin e kandidatit në të, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.



(ii) Kur kandidati ka kontribuar në sigurimin e të paktën 2 (dy) financimeve në bazë konkurimi në nivel ndërkombëtar, i cili ka sjellë përfitim për institucionin në rolin e koordinatorit të projektit, i evidentuar me dokumentin e lëshuar nga donatori i huaj ose përfituesi i financimit për rolin e kandidatit si koordinator, si dhe vlerësimin e njësisë bazë/kryesore ku aplikon kandidati, mbi përfitimin institucional nga ky projekt dhe rolin e kandidatit në të, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

2 (dy) artikuj shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit ose

2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(g) pjesëmarrja në vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare, për të cilat vlerësimi kryhet si më poshtë:

(i) Kur kandidati ka marrë pjesë në vlerësimin e të paktën 2 (dy) projekte kërkimore kombëtare, të dokumentuar me vërtetimin përkatës të financuesit të projektit për këto vlerësime, shoqëruar me vlerësimin që ka kryer, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(ii) Kur kandidati ka marrë pjesë në vlerësimin e të paktën 2 (dy) projekteve kërkimore ndërkombëtare, i dokumentuar me vërtetimin përkatës të financuesit të projektit për këto vlerësime shoqëruar me vlerësimin që ka kryer, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

2 (dy) artikuj shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(h) pjesëmarrja dhe angazhimi si drejtues në komitetet organizuese për të cilat vlerësimi kryhet si më poshtë:

(i) Kur kandidati është angazhuar si drejtues **i komitetit organizues** në të paktën 3 (tre) konferenca shkencore kombëtare, ku të ketë bërë vlerësimin apo peer review për të paktën 1 (një) referim shkencor në secilën konferencë, i dokumentuar me vërtetimin e institucionit organizues dhe të pranuar nga njësi bazë, shoqëruar me vlerësimin apo peer review që ka kryer kandidati, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

(ii) Kur kandidati ka qenë angazhuar si drejtues **i komitetit organizues** në të paktën 3 (tre) konferenca shkencore ndërkombëtare, ku të ketë bërë vlerësimin apo peer review për të paktën 1 (një) referim shkencor në secilën konferencë, i dokumentuar me vërtetimin e institucionit organizues dhe të pranuar nga njësi bazë, shoqëruar me vlerësimin apo peer review që ka kryer kandidati, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:



2 (dy) artikuj shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje ose

1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN

(j) pjesëmarrja në projektet e transferimit teknologjik të patentave, për të cilat vlerësimi kryhet si më poshtë:

Kur kandidati ka marrë pjesë në projektet e transferimit teknologjik të patentave, vërtetuar kjo me dokumentacionin përkatës lëshuar nga autoriteti përkatës ose vërtetimin që vërteton projektin e transferimit të teknologjisë, kjo veprimtari kualifikohet për ekuivalentim me:

1 (një) artikull shkencor, i botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI) dhe

1 (një) referim të mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20s, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në Proceedings (sipas nenit 17, pika 5 të kësaj Rregulloreje), të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

